



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PEJË

Numri i lëndës: 2019:207221

Datë: 03.09.2020

Numri i dokumentit: 01093009

P.nr.821/19

GJYKATA THEMELORE NË PEJË – Departamenti i Përgjithshëm, sipas gjyqtarit, Murat Hulaj, me pjesëmarrjen e zyrtares ligjore, Ylberza Gllogjani, në lëndën penale, kundër të pandehurit A.H. nga K. Pejë, i akuzuar për veprën penale të “Mashttrimit”, parashikuar nga neni 335 par 1 i Kodit Penal të Republikës së Kosovës, duke vendosur sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Pejë – Departamenti i Përgjithshëm, PP/II nr. 1952/19 të datës 17.09.2019, pas mbajtjes së seancës publike të shqyrtimit fillestar me dt.08.06.2020, në prezencë të prokurores së shtetit, Lumturije Vuçetaij, të pandehurit A.H., të njëjtën ditë mori dhe publikisht shpalli, ndërsa me dt. 01.07.2020, përpiloi këtë:

**NË EMËR TË POPULLIT
A K T G J Y K I M**

I akuzuari,

A. H. i lindur më, në të Malit të Zi, tani me banim në Pejë, hyrja B2, nr.64, i biri i H. H. dhe nënës N. H., e gjinisë A., i martuar, baba i 4 fëmijëve të cilët jetojnë me nënën e tyre pas divorcit, ka të kryer 8 vite të shkollës fillore, i gjendjes së mesme ekonomike, zdrukthëtar, për momentin i pa punë, posedon nr.tel ..., me numër personal, shqiptar, shtetas i R. Kosovës, mbrohet në liri.

ËSHTË FAJTOR

Për shkak se:

Qe nga vjeshta e vitit 2018, e me tutje ne kohe te pacaktuar e tutje, ne Peje ne me qellim te përfitimit te kundërligjshëm te dobisë pasurore për vete e ve ne lajthim te dëmtuarin F. H. Ballkan, ne atë mënyrë qe pasi i dëmtuari kishte porositur mobile ne mobilierinë "E...'", ku i pandehuri punon si punëtor dhe pasi kishte shkuar ne shtëpi përmes telefonit e kontakton këtu i pandehuri A. duke i ofruar një çmim me te lire për ti punuar këto mobile e për këtë janë dakorduar mes veti qe këto mobile i pandehuri ti punoje mobilet për 600 euro për çka fillimisht nga i dëmtuari kishte marre para prej 300 euro dhe kur i dëmtuari pas dy jave shkon për ti marre këto mobile, i pandehuri nxjerre justifikime e ndryshme për moskryerjen e obligimeve, pastaj i dëmtuari shkon edhe disa here me kërkesë te njëjte, por i pandehuri nuk ia kthen as parat e as nuk i punon mobilet,

- me çka ka kryer veprën penale “te mashtrimit” nga neni 335 par. 1, te KPRK-se.

Andaj, gjykata komfor nenit 7, 8 par. 1, 9, 10 par. 1, 17 par. 1, 21, 22, 41, 42, 43, 46,49, 51 dhe 335 par 1 të KPRK-së, dhe nenit 359, 360, 361, 365, 366, 450 par.1 pika 2.6, te KPPRK-se, të pandehurin e:

G J Y K O N

- Dënim me burgim në kohëzgjatje prej 6 (gjashtë) muajsh, dhe dënim me gjobë në shumë prej 400 (katërqind) euro, i cili dënim fare nuk ka për tu ekzekutuar nëse i pandehuri në afat prej 1 (një) viti nuk kryen vepër tjetër penale.
- Detyrohet i pandehuri që të dëmtuarit t'ia kthejë dobinë pasurore në shumën prej 300 (treqind) euro të fituar nga kryerja e veprës penale të mashtrimit dhe atë në afat prej 15 ditësh pasi që aktgjykimi të marrë formën e prerë në xhirologarinë bankare përkatëse që e mban në emër të firmës së tij, Mobilierinë ““E...””, e nën kërcënim të përmbarimit të dhunshëm.
- Detyrohet i pandehuri që në emër të shpenzimeve të procedurës penale në formë të paushallit gjyqësor të paguaj shumën prej 30(tridhjetë) euro, ndërsa në emër të kompensimit të viktimave të krimit shumën prej 30 euro, në afat prej 15 ditësh pasi që aktgjykimi të merr formën e prerë.
- Për realizimin e kërkesave eventuale pasurore- juridike pala e dëmtuar udhëzohet në kontest të rregullt civil.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Pejë – Departamenti i Përgjithshëm, ka ngrit aktakuzën PP/II nr. 1952/19 të datës 17.09.2019 , ndaj te pandehurit A. H. nga Fsh. ..., K. Pejë, i akuzuar për veprën penale të “Mashtrimit”, parashikuar nga neni 335 par, 1, i Kodit Penal të Republikës së Kosovës.

Gjykata, mbajti shqyrtimin fillestar, me datë 08.06.2020, ne pranin e Prokurores së Shtetit dhe të pandehurit, në të cilën seancë i pandehuri pasi që u njoftua me të drejtat e tij, me aktakuzën dhe provat kundër tij dhe pasi që prokurorja e shtetit lexoj aktakuzën, i akuzuari u deklarua se e pranon fajësinë për veprën penale me të cilën akuzohet.

Pas deklarimit te pandehurit se, e pranon fajësinë, mendimit te prokurores e cila nuk e kundërshtoj pranimin e fajësisë nga i pandehuri, Gjykata konstatoj se i pandehuri pranon fajësinë ne mënyre vullnetare dhe pa asnjë presion. I pandehuri është i vetëdijshëm për pasojat e pranimin te fajësisë, si dhe te gjitha kërkesat nga neni 248 par. 1, te KPPRK-se, janë përmbushur. Andaj, gjykata aprovoj pranimin e fajësisë nga ana e te pandehurit.

Duke pas parasysh se gjykata, ka aprovuar pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit dhe duke u ndërlidhur me atë se, ka vërtetuar se nuk ekziston asnjë rrethanë nga neni 253 par. 1 pika 1.1, 1.2 dhe 1.3 të KPPRK-së, si dhe faktin se janë plotësuar kushte nga neni 248 par 4, të KPPRK-së, atëherë, ne ketë çështje penale, nuk është zbatuar procedura e provave, por gjykata pas deklarimit të pandehurit se e pranon fajësinë ka vazhduar me shqiptimin e dënimit.

Me faktet e ofruara ne shkresat e lëndës, e po ashtu me pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit, është vërtetuar gjendja faktike e përshkruar si në dispozitiv të këtij aktgjykimi. Nga gjendja e vërtetuar faktike

si është përshkruar në dispozitiv të këtij aktgjykimit, rrjedh se në veprimet e të pandehurit A. H., qëndrojnë të gjitha elementet e veprës të “Mashtrimit”, parashikuar nga neni 335 par 1 të KPRK-së.

Sa i përket fajësisë, gjykata ka gjetur se, te i pandehuri, ka ekzistuar dashja, që veprën penale ta kryen në mënyrë të përshkruar si në dispozitiv të aktgjykimit, pasi që i pandehuri ka qenë i vetëdijshëm për veprën e kryer. Gjatë procedurës penale, nuk janë paraqit rrethana të cilat do ta zvogëlojnë apo përjashtojnë përgjegjësin penale të pandehurit, kështu që i njëjti është penalisht përgjegjës.

Duke vendosur lidhur me llojin dhe lartësinë e dënimit, gjykata i ka vlerësuar të gjitha rrethanat lehtësuese dhe rënduese në kuptim të nenit 73 të KPRK-së. Kështu si rrethana lehtësuese për të pandehurin, gjykata ka vlerësuar faktin se i njëjti më parë kishte sjellje korrekte dhe nuk kishte rënë asnjëherë në konflikt me ligjin. I pandehuri ka treguar sjellje korrekte gjatë shqyrtimit fillestar, duke pranuar fajësinë, dhe duke u ndier i përgjegjshëm për veprime e tij. Rrethana rënduese gjykata nuk gjeti.

Andaj, duke vlerësuar këto rrethana, Gjykata në kuptim të nenit 73 të KPRK-se të pandehurin e gjykoj si në dispozitiv të këtij aktgjykimit, me të cilin do të arrihet edhe qëllimi i dënimit.

Gjykata ka ardhur në përfundim se dënimi i shqiptuar të pandehurit është në përputhje me shkallen e përgjegjësisë penale të tij dhe me intensitetin e rrezikimit të vlerave të mbrojtura të shoqërisë. Gjykata gjithashtu është e bindur se vendimi mbi dënim do të shërbej për arritjen e qëllimit të dënimit në pengimin e të pandehurit në kryerjen e veprave penale në të ardhmen, por ai do të ndikoj edhe si preventive e përgjithshme për personat tjerë që të përmbahen nga kryerja e veprave penale në përputhje me nenin 41 të KPPRK-se.

Duke u bazuar në nenin 450 par. 1, 2 pika 2.6 të KPPRK-se, gjykata ka përcaktuar shpenzimet procedurale penale në formë të paushallit gjyqësor në shumë prej 30 euro, duke u bazuar në shpenzimet që janë shkaktuar nga fillimi i kësaj procedure e deri në përfundimin e saj.

Vendimi për kompensimin e viktimave të krimit, në shumën prej 30 euro, gjykata, e mori në përputhje me nenin 39, par.1,2,3, nën par. 3.1, të Ligjit për kompensim të viktimave të krimit, duke e obliguar të akuzuarin që ti paguaj shpenzimet e viktimave të krimit.

Vendimi për udhëzimin e palës së dëmtuar që për kërkesat eventuale pasuroro-juridike ta realizoj në kontest civil u morr në kuptim të nenit 463 par. 1 dhe 2 të KPPRK-së.

Nga arsyet e cekura më lartë dhe me zbatimin e nenit 370 të KPPRK-së është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA THEMELORE NË PEJË,
DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM
P.nr.821/19 më datë 01.07.2020**

Zyrtarja Ligjore,

Ylberza Gllgjani

Gjyqtari Gjyqës,

Dr.sc. Murat Hulaj

KËSHILLA JURIDIKE:

Kundër këtij aktgjykimi palët kanë të drejtë të parashtrajnë ankesë në afat prej 15 ditësh, nga dita e marrjes. Ankesa i dërgohet Gjykatës së Apelit në Prishtinë përmes kësaj Gjykate.